

NJOFTIM PËR PYETËSORIN STUDENTOR

I dashur student,

Në përmbushje të detyrimeve që burojnë nga Ligj Nr. 80/2015, Universiteti Politeknik i Tiranës organizon PyetëSORIN Studentor për cilësinë e mësimdhënies.

Nëpërmjet pyetëSORIT, çdo studenti i jepet mundësia të shprehë perceptimin mbi procesin mësimor si dhe të përcjellë pranë autoriteteve të universitetit shqetësime specifike.

Plotësimi i pyetëSORIT do të jetë i mundur duke filluar prej datës **13 Janar – 22 Janar 2026** nëpërmjet platformës online të sekretarisë mësimore.

Link: <http://bit-albania.com/>

Përgjigjet e pyetëSORIT përpunohen në mënyrë **ANONIME** nga UPT dhe mbi bazën e tyre hartohen të dhëna statistikore për problematikat kryesore të perceptuara nga studentët. Analiza e të dhënave kryhet pas përfundimit të sesionit të provimeve, duke shmangur çdo ndikim të mundshëm në vlerësimet përfundimtare.

Plotësimi i pyetëSORIT bëhet për çdo pedagog aktiv në semestrin aktual. Në llogarinë tuaj online do të shfaqet pyetëSORI vetëm për lëndët që frekuentoni si student i rregullt.

Universiteti Politeknik e vlerëson maksimalisht mendimin tuaj dhe ju nxit të merrni pjesë në këtë proces. Duke punuar së bashku, UPT mund të vijojë traditën e ekselencës e duke konsoliduar reputacionin kombëtar e rajonal.

Ju falënderojmë për bashkëpunimin,

Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë - UPT

Shënim:

- Për problematika në plotësimin e pyetëSORIT apo për pasaktësi në të, jeni i lutur t'i drejtoheni sekretarisë mësimore ose zyrës për sigurimin e cilësisë në fakultetin tuaj
- Për probleme të tjera lidhur me sigurimin e brendshëm të cilësisë në UPT mund të kontaktoni me Drejtorinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë: <https://upt.edu.al/drejtimi-akademik-administrativ/drejtorite/drejtoria-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise/>

PYETËSORI STUDENTOR


INFORMACION MBI MARRJEN E FJALËKALIMIT PËR HERË TË PARË

NË SEKRETARINË MËSIMORE ONLINE

Me qëllim pjesëmarrjen në PyetëSORIN Studentor për Vitin Akademik 2025-2026, Semestri I, studentët e vitit të parë dhe ata që nuk e kanë përdorur më parë Sekretarinë Mësimore Online duhet të aksesojnë Portalin në linkun:

<http://bit-albania.com/> (klikoni UPT)

Për marrjen e fjalëkalimit për herë të parë, ndiqni instruksionet në videon tutorial (shih ilustrimin më poshtë):



KLIKO KËTU PËR TË PARË VIDEON

Shënim:

- Për problematika në marrjen e fjalëkalimit, jeni i lutur t'i drejtoheni sekretarisë mësimore pranë fakultetit tuaj.
- Për probleme të tjera lidhur me sigurimin e brendshëm të cilësisë në UPT mund të kontaktoni me Drejtorinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë: <https://upt.edu.al/drejtimi-akademik-administrativ/drejtorite/drejtoria-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise/>